A DO TA BËJË AI BIZNESIN TUAJ X10?

Pesë hapa për ta futur AI-në në çdo biznes, në rendin që funksionon, dhe tri gjërat që e bëjnë të vështirë. Çdo hap mbyllet me diçka që duhet ta shkruani.

Engjell Rraklli · Themelues, division5 dhe divisionAI

METODË KISHIM GJITHMONË. THJESHT ISHTE E NGADALTË.

E themelova division5 në Shqipëri në 2015. Sot është një rrjet inxhinierësh nga i gjithë Ballkani, me fokus Shqipërinë dhe Kosovën. Që nga fillimi, biznesin e kemi përmirësuar në të njëjtën mënyrë, me katër hapa.

01 **Përcaktojmë**

Nga ajo që na thonë klientët dhe tregu.

02 **Vërtetojmë**

Me njerëzit që e bëjnë punën çdo ditë.

03 **Dokumentojmë**

Hap pas hapi.

04 **Automatizojmë**

Dhe e matim.

Metoda funksionon te. Problemi ishte koha. **Këta katër hapa na merrnin muaj**, sepse secili kërkonte shumë koordinim mes njerëzve të ndryshëm.

Pastaj bëmë pyetjen për të cilën është ky udhëzues: a mund ta bëjë AI më mirë?

NGA MUAJ NË JAVË

NËNTOR 2025
Nisëm me një sistem të vetëm.

PRILL 2026
Agjentët e parë AI.

QERSHOR 2026
Agjentët mësojnë.

GUSHT 2026
AI lexon CV-të dhe intervistat.

> **85%+**
>
> e proceseve të division5 ishin të automatizuara deri në nëntor 2026. Më parë, i bënin të gjitha njerëzit.

Sot AI punon në shitje, marketing, rekrutim, financë, operacione dhe HR, dhe ndihmon me çështjet ligjore. Një cikël optimizimi i një procesi ra nga muaj në javë.

Asgjë nuk nisi me AI. Nisi me futjen e biznesit në një sistem të vetëm. Pesë hapat që vijnë janë pikërisht ky rend, i shkruar që ta zbatoni në kompaninë tuaj, çfarëdo që shet ajo.

LISTONI PROCESET TUAJA

Jo departamentet. Punën. Çdo biznes, çfarëdo që shet, funksionon me një varg procesesh që përsëriten: gjetja e klientëve, shitja, dorëzimi, arkëtimi, punësimi, pagat, kontabiliteti.

Shumica e pronarëve nuk e kanë parë kurrë listën e plotë në një vend. Prandaj projektet me AI zakonisht nisin me atë që dukej mbresëlënëse në një demo, dhe jo me atë që i merr biznesit më shumë kohë.

Nuk mund të vendosni ku i takon AI-së derisa të shihni gjithçka që bën biznesi.

SHKRUAJENI

Çdo proces që përsëritet, nën gjashtë tituj: shitje, marketing, rekrutim, operacione, HR, financë. Përbri secilit, kush e bën sot dhe afërsisht sa orë në javë merr.

Pastaj rrethoni tre që marrin më shumë orë.

QENDËRZONI TË DHËNAT NË NJË VEND

Te division5 kjo do të thoshte kandidatë, klientë, kontrata dhe email-e. Te ju do të jetë ndryshe: porosi, stok, rezervime, pacientë, furnitorë. Rregulli është i njëjti.

AI nuk mund të veprojë mbi atë që nuk e sheh, dhe nuk sheh dot nëpër katër tabela Excel, tre kuti email-i dhe kujtesën e dikujt. Çdo përpjekje për ta anashkaluar këtë hap prodhon diçka që funksionon në demo dhe që askush nuk e përdor në praktikë.

Një vend i vetëm i besueshëm për çdo lloj të dhëne, dhe të gjithë dakord se cili është ai.

SHKRUAJENI

Për secilin nga tre proceset e rrethuara, të dhënat nga të cilat varet. Përbri secilës, ku ndodhet sot.

Çdo e dhënë me më shumë se një përgjigje është puna juaj e parë, para çdo AI-je.

NDËRTONI SOFTWARE MBI TË DHËNAT

Për ne, ky ishte sistemi ynë i menaxhimit: një vend ku punon i gjithë ekipi, i ndërtuar rreth mënyrës si funksionon realisht biznesi, dhe jo një shabllon ku e detyruam biznesin të përshtatej.

Nuk duhet domosdoshmërisht ta ndërtoni nga zero. Por duhet t'i përshtatet mënyrës si punon ekipi juaj, dhe ekipi duhet ta përdorë vërtet çdo ditë. Ajo që nuk funksionon është AI që qëndron pezull mbi mjete që askush nuk i hap.

Agjentët e hapit tjetër mund të jenë vetëm aq të mirë sa sistemi ku jetojnë.

SHKRUAJENI

Për çdo proces të rrethuar, mjeti i vetëm ku duhet të ndodhë puna. Nëse përgjigjja e sinqertë është „email dhe një Excel", shkruajeni edhe atë. Aty është boshllëku.

SHTONI AGJENTË AI

Agjenti është software që lexon, harton dhe propozon. Lexon email-in, CV-në, faturën. Harton përgjigjen, përmbledhjen, raportin. Propozon hapin tjetër.

Ajo që nuk duhet të bëjë është të vendosë. Rregulli ynë zë një rresht:

AI PROPOZON. NJERIU VENDOS.

Kjo i bën agjentët vendin e sigurt për të nisur. Një draft i gabuar që e kap një njeri kushton disa sekonda. Një vendim i gabuar që arrin te klienti ju kushton klientin.

SHKRUAJENI

Në çdo proces të rrethuar, hapat që nisin me leximin e diçkaje ose me shkrimin e një drafti të parë. Aty shkon agjenti juaj i parë. Përbri tij, kush do ta miratojë punën e tij.

SHTONI WORKFLOW-E AUTOMATIZIMI

Workflow-et janë pjesa që ecën vetë. Kur ndodh diçka, sistemi bën hapin tjetër pa asnjë njeri në mes: një përgjigje rutinë, një kujtesë, një regjistrim që kalon në fazën tjetër.

Vijnë të fundit për një arsye. Një workflow duhet ta marrë përsipër një hap vetëm pasi e keni parë atë hap të ndjekë të njëjtin rregull çdo herë. Një agjent që propozon të njëjtën përgjigje për muaj me radhë, me një njeri që e miraton çdo herë, është mënyra si i gjeni këta hapa.

Në fillim agjentët, pastaj workflow-et. Anasjelltas, gabimet arrijnë te klientët me shpejtësinë e makinës.

SHKRUAJENI

Vendimet në biznesin tuaj që ndjekin një rregull fiks pa asnjë përjashtim. Jini të rreptë. Nëse hezituat për ndonjërin, ai i takon një agjenti dhe një njeriu, jo një workflow-i.

NUK ISHTE E LEHTË

01 **E vështirë ta bësh mirë**

Të ndërtosh agjentë që bëjnë atë që duhet, me kosto të ulëta, është shumë e vështirë.

02 **E vështirë t'i besosh**

Sidomos kur agjenti duhet të bëjë detyra sikur të jetë ti.

03 **E ndërlikuar të gjesh balancën**

Shumë AI: gabimet arrijnë te klienti. Pak AI: njerëzit e bëjnë punën vetë.

Të gjithë duan të integrojnë AI. Pak dinë si.

Nuk mbaron kurrë

Procesi është iterativ dhe i vazhdueshëm. Kur sistemi nis të punojë, kërkon mirëmbajtje dhe optimizim të vazhdueshëm, që të japë rezultate të mira me kosto të pranueshme. Planifikojeni që në fillim, si çdo pjesë tjetër të biznesit që duhet të vazhdojë të funksionojë.

A DO TA BËJË AI BIZNESIN TUAJ X10?

Jo vetë. AI shumëfishon atë mbi të cilën qëndron. Në një biznes ku proceset janë të listuara, të dhënat janë në një vend dhe ekipi punon në një sistem, shumëfishon shumë. Mbi rrëmujën, e bën rrëmujën më të shpejtë.

Nëse biznesi juaj nuk po e përdor AI-në, nuk po lini vetëm para në tavolinë. Konkurrenca po i merr të gjitha.

Nëse doni ta bëni me mua

Kjo është puna që bëj me kompanitë. Në AI Integration Sprint, katër seanca në dy javë, i kalojmë këta pesë hapa për biznesin tuaj dhe dilni me një plan të shkruar. engjellrraklli.com/ai-sprint

Nëse keni një biznes shërbimesh, Constraint Sprint bën të njëjtën gjë së bashku me produktizimin e asaj që shitni, që AI të vendoset mbi punë që përsëritet. engjellrraklli.com/sprint

Kur plani është gati, divisionAI i ndërton këto sisteme. divisionai.co